STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 14 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ASISTENCEN E EMERGJENCES TE FEMA-S PER PRONARET E SHTEPIVE

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se FEMA do të japë Asistencë të Emergjencës për banorët e Nju Jorkut shtëpitë e të cilëve u prekën nga Uragani Sendi (Sandy). Me kërkesë të Guvernatorit, FEMA do të sjellë kontraktorë në mënyrë që të kryejnë riparime të thjeshta në mënyrë që banorët të mund të kthehen në shtëpitë e tyre ndërsa vazhdojnë riparimet më afat-gjata. Vetëm banorët në qarqet e shpallura në mënyrë federale kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë program. Pronarët e shtëpive në këto rajone që dëshirojnë të bëjnë kërkesë për ndihmë duhet të kontaktojnë zyrtarët e qarkut ose zyrtarët vendorë të tyre për të marë ndihmë prej kontraktorëve. Pronarët e shtëpive duhet të rregjistrohen me FEMA, gjë që mund t'a bëjnë duke telefonuar në 800-621-FEMA (3362).

FEMA ka krijuar një metodë me dy hapa për të ndihmuar individët që të bëjnë riparimet e nevojshme në shtëpitë e tyre. Ata do të përdorin programin e krijuar rishtazi Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (STEP) së bashku me Programin Individët dhe Shtëpitë (IHP) ekzistues në mënyrë që individët të qëndrojnë në shtëpitë e tyre, duke shmangur kështu nevojën për të gjetur zgjidhje të qëndrimit ose strehimit afat-gjatë. Këto programe mund të përdoren nga individët në të njëjtën kohë; pjesëmarrja në njërin nuk përjashton individët nga pjesëmarrja në tjetrin.

"Kur Uragani Sendi (Sandy) goditi shtetin tonë, banorët e Nju Jorkut panë shtëpitë e tyre të dëmtuara rëndë ose të shkatërruara krejtësisht," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Tani është koha të restaurojmë e të rindërtojmë këto shtëpi dhe të ndihmojmë që njerëzit të kthehen në shtëpitë e tyre në kohë për dimrin. Asistenca e FEMA-s do të bëjë një ndryshim të madh ndërsa vazhdojmë rimëkëmbjen afat-gjatë të Nju Jorkut. Falënderoj FEMA-n për partneritetin e vazhdueshëm të tyre gjatë kësaj kohe të vështirë."

Ekzekutivi i Qarkut të Nasos (Nassau) Eduard P. Mangano (Edward P. Mangano)deklaroi, "Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe unë punuam pa u lodhur me FEMA-n për të krijuar këto opsione novative të strehimit, të cilat së bashku me asistencën financiare, do të ndihmojnë që banorët të rindërtojnë jetën dhe shtëpitë e tyre."

Albanian

Majkëll Bërn (Michael Byrne), Punonjësi Bashkërendues Federal i FEMA-s, tha, “Zgjidhja është të kthejmë njerëzit në shtëpitë e tyre me siguri, duke hequr nevojën për strehime alternative. Do t’a bëjmë këtë me programin STEP. Ky është një program i emergjencës që synon të sigurojë një ndreqje të përkohëshme për të lejuar që njerëzit të jetojnë në shtëpi ndërsa rimëkëmben.”

Programi Individët dhe Shtëpitë siguron asistencë për individët dhe shtëpitë e prekura nga një katastrofë për t’u lejuar atyre që të trajtojnë shpenzimet e nevojshme dhe nevojat e mëdha, të cilat nuk mund të përmbushen nëpërmjet formave të tjera të asistencës ose sigurimit për katastrofat. Format e asistencës së strehimit sipas IHP-së përfshijnë strehimin e përkohëshëm, riparimin, zëvendësimin dhe ndërtimin gjysmë të përhershëm/të përhershëm të strehimit.

Programi Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (STEP):

- U lejon familjeve që të qëndrojnë në ose të kthehen në shtëpitë e tyre si një formë e strehimit ndërsa përfundojnë riparimet e përhershme.
- Programi përbëhet nga tre elementë të veçantë:
    - Riparimi i matësit elektrik të banesës
    - Masa thelbësore elektrike të përkohëshme
    - Riparime të shpejta të përkohëshme të pjesës së jashtme
- Shembuj të riparimeve që kualifikon përfshijnë: rregullimin e dritareve ose dyerve të jashtme, plasmas në taracë, punë elektrike të vogla, inspektime të nevojshme për stehim.
- Qeveria e shtetit dhe pushteti vendor janë aplikantë që kanë të drejtë për asistencë të drejtpërdrejtë federale dhe/ose rimbursime të kostove që kualifikohen sipas programit STEP.
- Pronarët individualë të shtëpive mund të përdorin pastaj Asistencën Individuale tradicionale të FEMA-s për të bërë riparime të përhershme në shtëpitë e tyre.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418